

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Fakulteti Juridik

Studimet Postdiplomike - MASTER

Programi: Kontratat dhe e Drejta Komeriale



PUNIM DIPLOME:

Përparësitë e arbitrazhit kundrejt gjykatës shtetërore për zgjidhjen e kontesteve ekonomike

Profesori:

Dr. iur. Iset Morina

Kandidati:

Elton Bibaj

Prishtinë, 2025

Abstrakt

Ky punim diplome fillon me një pjesë të shkurtër historike të kontesteve, duke vazhduar më pas me mekanizmat ndërkombëtar për arbitrazh, analizën teorike ligjore të arbitrazhit dhe gjykatave shtetërore, theksimin e strukturës, si dhe procedurat dhe natyrën e vendimeve të marra nga secila metodë.

Kërkimi i përdorur do të ndjekë një qasje krahasuese dhe analitike për të shqyrtuar përparësitë e arbitrazhit në krahasim me gjykatat shtetërore në zgjidhjen e kontesteve ekonomike. Kjo qasje do të përfshijë analizimin e literaturës akademike ekzistuese, Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventave Ndërkombëtare, ligjeve dhe rregulloreve, dokumenteve zyrtare, intervistave me profesionistë të fushës, si dhe mbledhjen e të dhënave përmes shqyrtimit të rasteve konkrete.

Tek në fund, punimi arrin në konkluzion se arbitrazhi përfaqëson një alternativë të vlefshme dhe shpeshherë më të përshtatshme për zgjidhjen e kontesteve ekonomike, duke ofruar përparësi të dukshme krahasuar me gjykatat shtetërore, si: shpejtësinë, fleksibilitetin procedural, mundësinë për të zgjedhur arbitra me ekspertizë specifike në fushën e kontesteve ekonomike, konfidencialitetin dhe ekzekutueshmërinë ndërkombëtare të vendimeve.

Ky punim është përpiluar duke pasur në mendje mangësitë e sistemit gjyqësor, vonesat, mos-efikasitetin, formalitetin e panevojshëm e rigoroz, ashtu që synon të kontribuojë në literaturën ekzistuese duke ofruar një analizë të thelluar dhe praktike mbi avantazhet e arbitrazhit. Punimi mund të shërbejë edhe si një udhëzues për profesionistët dhe palët e interesuara në fushën e zgjidhjes së kontesteve ekonomike.

Fjalët kyçe: arbitrazhi, përparësitë e arbitrazhit, zgjidhja e kontesteve ekonomike në arbitrazh, arbitrazhi kundrejt gjykatës shtetërore.